



Kingdom of the Netherlands



GJUHA DHE KRIMET E URREJTJES NË KOSOVË ANALIZË E RASTEVE NË PRAKTIKË

Ambasada Holandeze në Kosovë jo domosdoshmërisht i ndanë pikëpamjet dhe interpretimet e shprehura në këtë dokument.

Ky raport është realizuar në kuadër të projektit “Luftimi i Urrejtjes në Kosovë” i cili implementohet nga ATRC në partneritet me RADC dhe mbështetet nga Ambasada Holandeze në Kosovë.”

Hyrje

Në vazhdim të hulumtimit rreth gjuhës dhe krimeve të urrejtjes në Kosovë, ky raport paraqet pjesën e dytë të analizimit të raporteve të dorëzuara nga aktivitetet monitoruese, në kuadër të projektit “Luftimi i Urrejtjes në Kosovë” i cili implementohet nga ATRC në partneritet me RADC dhe mbështetet nga Ambasada Holandeze në Kosovë.

Përderisa në raportin e parë “Gjuha dhe Krimet e Urrejtjes në Kosovë: Roli i institucioneve në parandalimin e tyre”,¹ fokusi ishte analiza ligjore e koncepteve të gjuhës dhe krimeve të urrejtjes në kuadër të sistemit juridik të Kosovës si dhe në kuadër të normave dhe standardave ndërkombëtare, në këtë raport fokusi kryesor do të jetë në trajtimi ligjor i rasteve nga praktika të cilat janë analizuar dhe përshkruar nga aktivistë të organizatave lokale dhe studentë, dhe të cilët paraprakisht janë trajnuar mbi temat e të drejtave të njeriut dhe monitorimin e gjuhës dhe krimeve të urrejtjes.

Raporti mundohet të ofroj një qasje analitike ashtu që përmbajtja e raportimeve individuale të pasurohet me referime ligjore në mënyrë që të ndihmojë qytetarët e Republikës së Kosovës për të kuptuar dhe njohur më mirë konceptin juridik të gjuhës dhe krimeve të urrejtjes dhe për t’iu përgjigjur në mënyrë adekuate atyre. Raporti pasurohet poashtu duke theksuar edhe rolin e autoriteteve shtetërore dhe shoqërisë civile në luftimin dhe parandalimin e gjuhës dhe krimeve të urrejtjes.

Prandaj, përmes këtij raporti dhe prezantimit të rasteve konkrete, qytetarët do të kenë mundësi më të lehtë për evidentimin e përdorimit të gjuhës së urrejtjes në baza fetare, etnike, gjinore, racore dhe të tjera në publik dhe luftimin e këtij fenomeni i cili nxit akte apo krime të urrejtjes.

Duhet thënë se ndonëse raporti redakton aktivitetet e monitoruara, faktet e përshkruara nuk janë verifikuar, kështu që rastet e paraqitura përfaqësojnë kujtimin, perceptimin dhe hulumtimin e autorëve përkatës të aktiviteteve monitoruese. Ne besojmë se ato janë shkruar me mirëbesim dhe shërbejnë si tregues praktik i rasteve të cilat potencialisht është besuar se përbëjnë përdorim të gjuhës apo kryerjes së krime të urrejtjes.

¹ ATRC, “Gjuha dhe Krimet e Urrejtjes në Kosovë: Roli i institucioneve në Parandalimin e tyre” (Prishtinë, 2021), https://advocacy-center.org/ep-content/uploads/2021/08/Raporti_monitorimit.pdf, qasur me 4 shtator 2021.

Hyrje.....	2		
2. Metodologjia	4	3.6. NXITJA E URREJTJES GJATË FESTËS SË VIDOVDANIT NË GAZIMESTAN.....	17
2.1. Evidentimi i Gjuhës së Urrejtjes.....	4	3.7. RASTI I GJUHËS SË URREJTJES NË KOMUNËN E NOVOBËRDËS.....	18
2.2. Evidentimi i Krimeve të Urrejtjes.....	6	3.8. Rasti i gjuhës së urrejtjes përmes veprave letrare.....	19
3. Rastet praktike të monitoruara të shprehjeve të supozuara si gjuhë e urrejtjes apo krim i urrejtjes	7	4. KANOSJA SI KRIM I URREJTJES DHE MONITORIMI I PUNËS SË POLICISË DHE PROKURORISË LIDHUR ME KËTË VEPËR	21
3.2. RASTI I SULMIT NË FERIZAJ NDAJ PERSONIT PËR SHKAK TË MOTIV- IT TË ORIENTIMIT SEKSUAL TË VIKTIMËS.....	10	5. Rasti i monitoruar në komunën e Mitrovicës: Dallimi në mes të diskriminimit dhe gjuhës apo krimit të urrejtjes.....	26
3.3. NXITJA E URREJTJES NDAJ KOMUNITETIT TURK PËRMES DJEGJES SË FLAMURIT.....	11		
3.4. NXITJA E URREJTJES (MOHIMI I MASAKRËS SË REÇAKUT) NGA MINISTRI I ADMINISTRATËS DHE PUSHTETIT LOKAL	13		
3.5. NXITJA E URREJTJES NË RRJETE SOCIALE NË PEJË.....	16		

2. Metodologjia

2.1 Evidentimi i Gjuhës së Urrejtjes

Në identifikimin e gjuhës së urrejtjes si bazë mbi të cilin do të orientohet ky raport është definicioni nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës në Rekomandimin R (97) 20. Sipas këtij definicioni: Gjuha e urrejtjes përkufizohet si *“të gjitha format e shprehjes që përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen racore, ksenofobinë, antisemitizmin ose forma të tjera të urrejtjes bazuar në intolerancë, duke përfshirë: intolerancën e shprehur nga nacionalizmi dhe etnocentrizmi agresiv, diskriminimi dhe armiqësia kundër pakicave migrantëve dhe njerëzve me origjinë emigrante”*.² Në këtë kuptim, gjuha e urrejtjes paraqet një shprehje të publike të një qëndrimi diskriminues, të cilat domosdoshmërisht drejtohen kundër një personi ose një grupi të veçantë personash, dhe e cila mund të përhap paragjykitime dhe mund të krijon një marrëdhënie intolerance, armiqësie ose të provokoi dhunë ndaj grupeve apo individivë të cilat i përkasin këtyre grupeve.

Ndërkohë në mënyrë që të i mëveshet edhe aspekti formalistik ligjor, do të shërbehemi me nenin 141 të Kodit Penal të Kosovës, në të cilën theksohet se: *“Kushdo që nxit ose përhap publikisht urrejtje, përçarje dhe mos durim midis grupeve kombëtare, racore dhe fetare, etnike e të tjera, apo bazuar në orientimin seksual, identitetin gjinor dhe karakteristikat e tjera personale, në mënyrën e cila mund të prishë rendin publik dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë (5) vjet”*³; si dhe Nenin 4 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili i referohet drejtpërdrejt gjuhës së urrejtjes: *“Nxitja për të diskriminuar*

konsiderohet diskriminimi mbi bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji çkararakteristikat personale të mbrojturaç, dhe përfshin çdo promovim të urrejtjes kur ajo bëhet me dashje”. Mbi këto definicioni do të analizojmë nëse rastet e raportuara përbëjnë gjuhë të urrejtjes.

Gjuha e urrejtjes si koncept juridik në sistemin juridik të Kosovës mund të trajtohet në aspekt penal dhe atë civil. Kategorizimi i gjuhës së urrejtjes si vepër penale konsiston me atë, kur kryersi përdor gjuhë të tillë me të cilën nxit ose përhap publikisht urrejtje, përçarje dhe mos durim midis grupeve kombëtare, racore, fetare, etnike e të tjera, apo bazuar në orientimin seksual, identitetin gjinor dhe karakteristikat e tjera personale, në mënyrën e cila mund të prishë rendin publik. Pra element esencial që të konsumohet vepra penale me rastin e gjuhës së urrejtjes në kuptim penal është mundësia që të prishet rendi publik. Rrjedhimisht duhet që vepra të ketë inkurajuar pasoja *“të rënda”* për lirinë dhe të drejtat e të tjerëve ose një poshtërim të rëndë të të tjerëve mbi baza diskriminuese.

Ndërkohë në kuadër të procedurës kontestimore, për të konstatuar se një shprehje përbën gjuhë të urrejtjes sipas qëllimit duhet të bëhet me dashje, shprehet në një kontekst që mund të nxitë diskriminim dhe ka për pasojë promovim të urrejtjes. Pa përmbushjen e këtyre parakushteve atëherë nuk mund të konsiderohet se një shprehje e caktuar është gjuhë e urrejtjes.

² Këshilli i Evropës, “CoE Hate Speech Factsheet” [ëëë.coe.int/t/DC/Files/Source/FS_hate_en.doc](https://www.coe.int/t/DC/Files/Source/FS_hate_en.doc), qasur me shtator 2021.

³ Kodi Nr. 06/L-074 Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 141 paragrafi 1 (GZ, nr. 2/2019, 14 janar 2019).

Sidoqoftë, duke qenë se gjuha e urrejtjes si koncept juridik mund të përceptohet në mënyra të ndryshme nga njëzit, atëherë analizimin e rasteve se kur një shprehje përbën gjuhë të urrejtjes, dhe përcaktimin e kufirit midis shprehjes të kundërshtueshme dhe fyese, por jo të dënueshme, dhe gjuhës së urrejtjes e cila është në kundërshtim me ligjin, do ta bazojmë edhe në analizën e disa kushte kumulative:

- a. Konteksti i shprehjes;
 - b. Folësi;
 - c. Qëllimi;
 - d. Përmbajtja e shprehjes;
 - e. Shtrirja dhe intensiteti i shprehjes; dhe
- Gjasat e shprehjes për të krijuar pasojë të rëndë shoqërore.

a. Konteksti dhe rrethanat shoqërore

Si hap i parë në vlerësimin nëse një shprehje përbën gjuhë të urrejtjes, do të shikojmë kontekstin dhe rrethanat shoqërore kurë është thënë ajo shprehje.

Në përgjithësi, një analizë e kontekstit duhet të përfshijë konsideratë për elementet e mëposhtme:

- Ekzistenca e konflikteve brenda shoqërisë. Pra faktin nëse kanë ekzistuar konflikte të mëparshme midis grupeve të ndryshme apo shpërthime të dhunës.
- Ekzistenca dhe historia e institucionalizuar e diskriminimit. Ekzistimi i pabarazisë strukturore dhe diskriminimit historik ndaj një grupi të caktuar. Mungesa e kundërshtimit të shprehjeve të drejtuara ndaj një grupi të caktuar.
- Histori e përplasjeve dhe konflikteve në mes të grupit të cilit i përket folësi dhe grupit ndaj të cilit drejtohet fjalimi

- **b. Folësi**
- Identiteti i folësit, veçanërisht pozita dhe statusi i tyre në shoqëri si dhe qëndrimet ose ndikimi, do të të analizohen.

Çështjet që do të mirren parasysh përfshijnë:

- Pozicioni zyrtar i folësit - nëse ai/qjo është në një pozicion të autoritetit mbi audiencën;
- Niveli i autoritetit të folësit ose ndikim mbi audiencën dhe karizma e tij/saj;
- Nëse deklarata është bërë nga një person në cilësinë e tij/saj zyrtare, në veçanti nëse ky person kryen detyra dhe funksione të veçanta.

c. Qëllimi

Analizë e qëllimit të folësit, përkatësisht:

- Dashjes për t'u angazhuar në avokim ndaj urrejtjes;
- Dashjes për të targetuar një grup të caktuar mbi bazën e karakteristikave të mbrojtura;
- Të pasurit njohuri për pasojat e veprimeve duke e ditur se pasojat do të ndodhin ose mund të ndodhin.

d. Përmbajtja e shprehjes

Analiza e përmbajtjes do të përfshijë përqëndrimin në çështje të tilla si: forma, stili, toni, faktin nëse shprehja përmbante thirrje direkte për diskriminim ose dhunë, natyra dhe mënyra se si shtrohen argumentet.

e. Shtrirja dhe intensiteti i shprehjes

Faktor i rëndësishëm në shqyrtimin nëse shprehja arrin pragun e nxitjes së urrejtjes duhet të jetë një ekzaminim i shtrirjes dhe intensitetit të shprehjes. Në këtë kuptim në do të shqyrtojmë, në veçanti tri çështje kryesore:

- Natyrën Publike të shprehjes
- Mjetet e përhapjes së shprehjes; dhe
- Impakti i shkaktuar nga shprehja

f. Gjasat e shprehjes për të krijuar pasojë të rëndë shoqërore.

Në mënyrë që një shprehje të analizohet nëse arrin pragun e nxitjes së urrejtjes, do të analizojmë lidhjen shkak-pasojë në mes të komunikimit nga folësi dhe mënyrës së si pritët nga audienca dhe si potencialisht audienca do të mund të reagojë. Në këtë mënyrë do të analizojmë nëse ka ekzistuar një probabilitet i arsyeshëm dhe direkt, që një fjalim do të kishtë sukses në nxitjen e audiencës që të shkaktojë diskriminim, dhunë ose armiqësi kundër një grupi të caktuar për shkak të karakteristikave të tyre personale. Kriteret për vlerësimin e

probabilitetit ose rrezikut për nxitje diskriminimi, armiqësie ose dhunë duhet të analizohen rast pas rasti, por duke analizuar kriteret si më poshtë:

- A ishte fjalimi i kuptuar nga audienca si thirrje për akte të diskriminimit, dhunës apo armiqësisë?
- A kishte mundësi folësi të ndikonte tek audienca?
- A kishte mundësi audienca që përmes fjalimit, të nxitej në kryerje të akteve të diskriminimit, dhunës apo armiqësisë?
- A ishte grupi i targetuar i viktimave, kohëve të fundit objekt i diskriminimit, dhunës apo armiqësisë?

2.2 Evidentimi i Krimeve të Urrejtjes

Në analizën nëse është kryer 'krimi i urrejtjes' do të bazohemi në gjetjen e dy elementeve bazë, gjë që përbëjnë edhe elementet kryesore të një krimi të urrejtjes:

- Fakti i kryerjes së një veprë penale "bazë" (p.sh. vrasje); dhe
- Vepra penale e kryer nga një "motivim i njëanshëm" (p.sh. kundër përkatësisë etnike), që do të thotë se kryerësi ka zg-

jedhur shënjestrën e krimit bazuar në karakteristikat personale të mbrojtura të viktimës.

Evidentimi i krimit të urrejtjes, nënkupton se Gjykata me rastin e konstatimit të fajit, nëse vepra penale është kryer mbi bazën e motivimit të njëanshëm ndaj karakteristikave të mbrojtura atëherë kjo do të klasifikohet si rrethanë rënduese për të cilën gjykata duhet ta marrë parasysh me rastin e caktimit të dënimit.

3. Rastet praktike të monitoruara të shprehjeve të supozuara si gjuhë e urrejtjes apo krim i urrejtjes

3.1 NXITJA E URREJTJES PËRMES RRJETEVE SOCIALE NDAJ POLICIT SERB NË KOMUNËN E ISTOGUT⁴

Një formë e shpeshtë e nxitjes apo përhapjes së urrejtjes është ajo përmes rrjeteve sociale. Konkretisht, me datë 14 tetor 2020, përmes profilit të tij B.B përmes rrjetit social nxitë publikisht urrejtje në mes grupeve kombëtare dhe atë në mes kombit shqiptar dhe atij boshnjak e serb, në mënyrën e cila mund të prish rendin juridik. me çka ka kryer veprën penale “nxitja e përçarjes dhe mos durimit” nga neni 141 paragrafi 1 të Kodit Penal të Kosovës, për të cilën Prokuroria Themelore në Pejë ngriti aktakuzë.

Nga një faqe publikohet artikulli i titulluar “Alarmuese 15.000 qytetar Istogas, kanë aplikuar për vizë” i pandehuri si komentues i dal-

luar i kësaj faqe (top fan) komenton në këtë artikull ku ndër të tjera publikisht shkruan “*nuk kanë qare pa ikë nga ky vend, ku hala na mall-tretojnë boshnjaket e shkitë në polici të Istogut e shipecat ja u nënshkruajnë... veç në kohën e shkive edhe tash në Istog po ndodh kur traktori godet veturën në pjesën e prapme e lihet fajtor shoferi i veturës e i bahen 100 maltre-time...*”.

Gjate shqyrtimit fillestar, pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit i pandehuri ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohet, duke thënë se nuk ka qenë qëllimi që ta ngacmojë

4 Gjykata Themelore Pejë, Rasti P.nr. 319/20, https://peje.gjyqesori-rks.org/epcontent/uploads/verdicts/PE_IS_P_2020-151382_SQ.pdf, qasur më 6 shtator 2021.

dikënd apo të nxisë përçarje dhe mos durim midis grupeve kombëtare apo racore por këtë e ka bërë nga mllefi për një rast që kishte pasur prindi i tij në polici ku i është bërë një e padrejtë, dhe shkrimin e publikuar e ka fshirë nga faqja .

Si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjykata gjeti se i pandehuri ka treguar sjell-

je korrekte në Gjykatë, e për më tepër e ka pranuar fajësinë dhe ka shpreh keqardhje për veprat që i ka kryer, i njëjti deklaroi se është penduar për veprimet e tija, duke i kërkuar falje para gjykatës të dëmtuarit. Andaj, në bazë të gjendjes faktike dhe peshës së veprave penale, Gjykata i shqiptoi të pandehurit dënime unik me gjobë në shumën prej 400 (katërqind) euro.

3.1.1. Vlerësimi nëse ka ekzistuar gjuha e urrejtjes

Fillimisht duhet thënë se, Gjykata në arsyetimin e dispozitivit lidhur me konstatimin e kryerjes së veprës penale "nxitja e përçarjes dhe mos durimit" nga neni 141 paragrafi 1 i Kodit Penal, nuk jep ndonjë analizë në bazë të së cilës krijon lidhshmërinë në mes të së drejtës materiale dhe situatës faktike. Gjykata në aktgjykimin e saj, duket se mjaftohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit. Sidoqoftë, ndonëse gjykata nuk lëshohet në një arsyetim të gjatë të dispozitivit, prima facie mund të konstatohet ekzistimi i gjuhës së urrejtjes. Kjo

për faktin se shprehja "nuk kan qare pa ikë nga ky vend, ku hala na malltretojnë boshnjaket e shkitë në polici të Istogut...", paraqet një rast të qartë ku gjuha e përdorur ka mundur të ofendoj, shqetësoj apo trondit komunitetet e theksuara, por edhe duke proklamuar se policët e etnicitetit serb dhe boshnjakë, po malltretojnë në këtë rast komunitetin shumicë, një shprehje e tillë shpreh tendencë që duke nxitur urrejtje ndaj policëve të këtij komuniteti, kjo të përshkallzohet në dhunë ndaj tyre.

Vlerësimi i kontekstit dhe rrethanave shoqërore

Gjykata është dashur të vlerësoj kontekstin e shoqërisë kosovare. Në këtë aspekt ajo është dashur të vlerësoj se duke qenë se kanë ekzistuar konflikte të mëparshme midis grupeve përkatëse, a ka qenë e mundur që në kuadër të këtij konteksti të nxitet dhunë. Konkludimi në këtë rast do të ishte se në një situatë të tillë të konflikteve të mëparshme në shoqërinë tonë, shprehja e tillë paraqet, një tendencë për nxitje

të urrejtjes, ndaj policëve të përkatësisë boshnjake dhe serbe. Kjo pasi që një shprehje e tillë, ringjall kujtimet e konflikteve të mëparshme, dhe mëvesh një ngjarje individuale ndaj një komuniteti në përgjithësi dhe pretendon se trajtimi i pretenduar i pavaforshëm i të pandehurit, ka ndodhur si shkak i përkatësisë etnike boshnjake dhe serbe të policisë.

Vlerësimi i pozitës së folësit

Gjykata është dashur të vlerësoj pozitën dhe statusin e të pandehurit në shoqëri. Në këtë kuptim nga aktgjykimi vërehet se i pandehuri më profesion është Profesor. Prandaj, duke qenë në pozitë të tillë, mundësia që i pandehuri të ketë mundur të ndikoj në një audiencë

më të zgjeruar sidomos tek nxënësit e tij është e madhe. Në një komunitet lokal si atë të Istogut, një profesor i cili shpreh gjuhë të tillë tendencioze mbi baza të përkatësisë etnike, paraqet rrezik për nxitje të urrejtjes.

Qëllimi i folësit

Ndonëse nga arsyetimi i aktgjyimit nuk shpjegohet nëse dashja ka qenë eventuale apo e qëllimshme. Nga mënyra se si është shprehur folësi, mund të analizohet se ka pasur dashje të qëllimshme për të targetuar policët mbi bazën e karakteristikave të tyre etnike. I pan-

dehuri është dashur të ketë njohuri se veprimi i tij mund të kishte shkaktuar pasoja të tilla, ku në mënyrë zingjyrore do të nxitej urrejtje ndaj këtyre policëve, duke shkaktuar një situatë pa-sigurie për ta.

Shtrirja dhe intensiteti i shprehjes

Folësi duke qenë 'top fan' në faqën e facebookut, ka qenë dashur të dijë se shprehja e tij, sidomos përmes rrjeteve sociale dhe e

natyrës publike, do të mund të kishte impakt të një audiencë e gjërë.

Gjasat e shprehjes për të krijuar pasojë të rëndë shoqërore.

Ekziston probabilitet i arsyeshëm që shprehja të shkaktonte nxitje të urrejtjes, duke qenë se folësi e atribuon numrin e madh të aplikimeve për vizë në komunën e Istogut, si pasojë e sjelljeve të policëve të përkatësisë etnike serbe dhe boshnjake.

3.2 RASTI I SULMIT NË FERIZAJ NDAJ PERSONIT PËR SHKAK TË MOTIVIT TË ORIENTIMIT SEKSUAL TË VIKTIMËS⁵

Prokuroria Themelore në Ferizaj kishte ngritur aktakuzë ndaj dy të akuzuarve për shkak të veprave penale të nxitjes së urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar apo etnik si dhe veprës penale lëndim i lehtë trupor.

Kjo kishte ndodhur për shkak se me 11 qershor 2016, brenda stacionit të trenit në Ferizaj, të pandehurit zhvilluan një bisedë për t'i rrahur dy persona për motivin *"se janë peder"*. Megjithëse bashkëbiseduesi fillimisht refuzoi të bënte një gjë të tillë, prap u bind të merete pjesë. Kështuqë ushtruan dhunë ndaj të dëmtuarit, duke shkaktuar lëndime trupore, të vërtetuara edhe nga ana e ekspertizës mjeko-ligjore. Pastaj të dëmtuarit u ndeshën prap me të akuzuarit në një restaurant, të cilët vazhduan të fyenin, me ç'rast lajmëruan policinë.

Në bazë të provave, Gjykata Themelore në Ferizaj shpallë fajtor të akuzuarin e parë për të dy veprat penale duke i shqiptuar dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej pesë (5) muaj, të cilin dënim do të vuaj pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Ndërsa të akuzuarin tjetër, Gjykata e shpallë fajtor për veprën penale "lëndim i lehtë trupor" dhe i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej katër (4) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afatin prej një viti nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë nuk kryen vepër tjetër penale. Ndërsa për veprën penale të nxitjes së urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar apo etnik, lirohet nga akuzat, në mungesë të provave.

3.2.1 Vlerësimi nëse ka ekzistuar gjuha e urrejtjes

Në rastin në fjalë prima facie mund të konstatohet se Gjykata dhe Prokuroria gabimisht kanë kualifikuar veprën penale, kjo pasi që në rastin në fjalë nuk kemi të bëjmë me veprën penale 'nxitje e urrejtjes përçarjes ose mos durimit kombëtar'. Kjo për faktin se nga përshkrimi faktik i situatës mund të kuptohet se i akuzuari i parë, shprehjen *"hajde shkojmë i rrahim qata se janë peder dhe se këta i kam rreh disa here"*, nuk e shpreh

publikisht dhe nuk krijon një pasojë përmes së cilës arrin të nxit të pandehurin tjetër që të shkaktoj dhunë. Kjo kuptohet, nga ajo se i akuzuari i dytë i përgjigjet *"leje se nuk ke punë me ta"*. Pra i akuzuari i parë, përmes shprehjes – së thënë në një kontekst privat – në një pozitë mbi të cilin nuk kishte ndonjë autoritet mbi të akuzuarin e dytë, nuk arrin që tek i akuzuari i dytë të promovojë nivelin e nxitjes efektive të dhunës.

⁵ Gjykata Themelore Ferizaj, Rasti P.nr.620/16, https://ferizaj.gjyqesori-rks.org/ep-content/uploads/verdicts/FE_P_620_16_SQ.pdf, qasur me 8 shtator 2021.

Sidoqoftë, ndonëse rasti nuk kishte të bënte me nocionin juridik të gjuhës së urrejtjes.⁶ Vepra në fjalë, sigurisht pasqyron urrejtje apo motivim të njëanshëm të të akuzuarit të parë, mbi bazën e orientimit seksual. Në këtë kuptim kemi të bëjme me krim të urrejtjes nga i akuzuari i parë, kjo sepse plotësohen dy elementet që përbëjnë nocionin juridik të 'krimit të urrejtjes'.

Fillimisht i akuzuari i parë kryen aktin i cili përbën veprën penale sipas të drejtës pozitive penale, përkatësisht veprën penale 'lëndim i lehtë trupor' dhe këtë veprë e kryen duke qenë se motivimi për kryerjen e kësaj veprë penale ishte paragjykimi që ai ka ndaj shënjestrës për shkak të lidhjes së tij reale ose të përceptuar, përkatësisht ose mbështetjes së një grupi të mbrojtur në bazë të orientimit seksual të tyre si karakteristikë personale e mbrojtur e tyre.

Rrjedhimisht, gjykata për të akuzuarin e parë është dashur që të marrë motivin e njëanshëm (urrejtjes) në llogari dhe të shqiptoj një dënim më të rëndë. Me Kodin Penal që është në fuqi,⁷ kjo veprë do të cilësohej si një rre-

thanë e veçantë kualifikuese në bazë të së cilës përcaktohet një formë e veçantë e rënduar e veprës penale themelore, me një dënim të shqiptuar më të rëndë se ai i parashikuar për formën themelore të veprës penale në fjalë (në rastin në fjalë veprë penale nga neni 185, paragrafi 3, nënparagrafi 1). Megjithatë, vepra ka ndodhur kur ishte në fuqi Kodi i vjetër penal,⁸ i cili tash është shfuqizuar. Ky kod, nuk përcaktonte formën e veçantë e të rënduar të veprës penale themelore, pra nuk përcaktonte urrejtjen si element juridik të veprës penale, megjithatë urrejtjen (motivin e njëanshëm) e përcaktonte si rrethanë e kërkuar rënduese, në bazë të secilit shqiptohet një dënim më i rëndë. Rrjedhimisht, gjykata gabon kur konstaton në arsyetim, se kanë munguar rrethanat veçanërisht rënduese. I akuzuari i parë, pra është dashur të dënohej me rëndë, duke qenë se kryen veprën penale nga motivimi i njëanshëm, ndërsa tek i akuzuari i dytë ndonëse kryen veprën penale, nga përshkrimi i situatës mund të konkludojmë se ai nuk ka qenë i motivuar nga motivi për shkak të orientimit seksual të viktimës.

3.3. NXITJA E URREJTJES NDAJ KOMUNITETIT TURK PËRMES DJEGJES SË FLAMURIT⁹

Më 24.09.2018 Prokuroria Themelore në Gjakovë kishte ngritur aktakuzë ndaj B.B dhe A.B, të akuzuar për shkak të veprës penale nxitja e urrejtjes, përçarjes, ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik. Të akuzuarit, më datë 02 gusht 2018, me vetëdije kishin nxitur, përha-

pur publikisht urrejtje, përçarje dhe mos durim midis grupeve kombëtare, racore, fetare, etnike të grupeve që jetojnë në Republikën e Kosovës me qëllim të prishjes së rendit publik, ashtu që publikisht djegin flamurin kombëtar të Republikës së Turqisë, të cilin e paraqesin

⁶ Shiko për më shumë: ATRC (n1).

⁷ Kodi Nr. 06/L-074 Kodi Penal i Republikës së Kosovës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>

⁸ Kodi Nr. 04/L-082 Kodi Penal i Republikës së Kosovës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>

⁹ Gjykata Themelore në Gjakovë, P. nr. 655/18, https://gjakove.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/GJK_P_P_nr.655_18_SQ.pdf.

përmes rrjeteve sociale duke bërë titur "Poshtë Turqia", "Poshtë Erdogan ". Rrjedhimisht, duke u akuzuar se kishin krijuar pakënaqësi fyerje dhe urrejtje ndaj kombit turk si dhe nacionalitetit turk që jeton në Kosovë. Ndaj këtij akti ka reaguar edhe Qeveria e Republikës së Kosovës. Në deklaratën e Qeverisë thuhet se "dënohet fuqishëm çdo akt vandal që përdhosë simbollet nacionale dhe shtetërore të Republikës së Turqisë", "Qeveria e Kosovës është e përkushtuar në ndërtimin e raporteve të mira me të gjitha vendet e rajonit dhe ka konsideratë të veçantë për bashkëpunimin e mirë me vendet që kanë njohur dhe ndihmuar pavarësinë e Kosovës. Qeveria e Republikës së Kosovës

është e vendosur dhe kërkon nga organet e rendit që të ndërmarrin të gjitha masat ndaj atyre që nuk respektojnë interesat shtetërore të Kosovës dhe ndaj atyre që prishin harmoninë dhe bashkëjetesën e qytetarëve të saj, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike".¹⁰

Andaj, ndaj të akuzuarve, Gjykata ka shqiptuar dënime me gjobë, në shumë prej 2.500 Euro për secilin, e në rast se të akuzuarit nuk e paguan dënimin me gjobë, i njëjti do u zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve.

3.3.1. Vlerësimi nëse ka ekzistuar gjuha e urrejtjes

Gjykata në rastin në fjalë ndonëse konstatimin e fajësisë e bazon në pranimin e fajësisë së të pandehurve, në të vërtetë si çështje është shumë e diskutueshme.

Gjykata vendimin e vet e bazon në faktin se "në një aheng familjar në hotelin "P." me vetëdije nxisin, përhapin publikisht urrejtje, përçarje dhe mos durim midis grupeve kombëtare, racore, fetare etnike të grupeve që jetojnë në Republikën e Kosovës me qëllim të prishjes së rendit publik, ashtu që publikisht djegin flamurin kombëtar të Republika Turqisë, të cilin e paraqesin përmes rrjeteve sociale duke bërë titur "Poshtë Turqia", "Poshtë Erdogan", të cilat kanë krijuar pakënaqësi dhe fyerje dhe urrejtje ndaj kombit turk si dhe nacionalitetit turk që jeton në Kosovë."

Në këtë kuptim nëse e shohim kontekstin në të cilin është zhvilluar ngjarja, kemi të bëjmë me një aheng familjar në një rënë anë, së dyti

nëse e shohim cilësitë e këtyre personave, kemi të bëjmë me persona të thjeshtë, të cilët veprimet e tyre i kanë bërë në cilësi private. Për më shumë, ata me veprimet e tyre nuk kanë targetuar specifikisht komunitetin turk që jeton në Kosovë, por kanë shprehur pakënaqësinë e tyre ndaj shtetit të Republikës së Turqisë dhe udhëheqësit të saj. Në anën tjetër në asnjë moment nëse analizohet përmbajtja nuk shihet ndonjë synim që ndaj komunitetit turk është bërë thirrja që ndaj tyre të nxitet diskriminimi ose urrejtja. Ndërsa, ndonëse komuniteti turk është ndier i ofenduar nga djegia e flamurit, nga rasti kuptohet se veprimi i personave të akuzuar nuk e ka cenuar pozitën shoqërore të pjesëtarëve të komunitetit turk.

Lidhur me këtë, nëse shohim jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në rastin e Partisë Demokratike Kristiane kundër Moldavisë,¹¹ GJEDNJ konsideron se djegia e flamujve mund të jetë, në kontekste të caktu-

10 <https://boldnews.al/2018/08/03/turqit-kane-bere-gjenocid-ndaj-shqiptare-ne-kosove-djegin-flamurin-turk-reagon-qeveria/>

11 <http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-72346>

ara, një mënyrë legjitime për shpërndarjen e opinionëve politike: *"Në rastin aktual, Gjykata konstaton se parullat e palës ankuese, edhe nëse i shoqëruar me djegien e flamujve dhe fotografive, ishte një formë e shprehjes së një opinioni në lidhje me një çështje me interes të madh publik, përkatësisht praninë e trupave ruse në territorin e Moldavisë. Gjykata kujton në këtë kontekst se liria e shprehjes nuk i referohet vetëm "informacionit" ose "idesë" që merren ose konsiderohen në mënyrë të favorshme si joofenduese ose si çështje indiferente, por edhe atyre që ofendojnë, trondisin ose shqetësojnë."*

Prandaj në rastin në fjalë, ndonëse veprimi i të akuzuarve ka mundur të ofendoj komunitetin e përkatësisë etnike turke, një veprim i tillë të akuzuarve nuk mund të arsyetohet se ka nxitur urrejtje ndaj komunitetit turk dhe në thelb ka paraqitur një formë të pakënaqësisë së të akuzuarve në lidhje me situatën politike në Turqi. Në fakt, detyrë e gjykatës në këtë rast do të ishte të konstatonte qëllimin që kanë pasur të akuzuarit, nëse qëllimi ka qenë i drejtuar drejt nxitjes së urrejtjes ndaj komunitetit turk, apo për shkak të indinjatës ndaj politikave të shtetit turk, gjë që gjykata ka dështuar ta provojë.

3.4. NXITJA E URREJTJES (MOHIMI I MASAKRËS SË REÇAKUT) NGA MINISTRI I ADMINISTRATËS DHE PUSHTETIT LOKAL¹²

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës me datë 28 qershor 2019 ka ngritur aktakuzë ndaj të akuzuarit I.T për shkak të veprës penale: Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik. I akuzuari, në cilësinë e Ministrit të Administratës dhe Pushtetit Lokal në Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke e keqpërdorur pozitën apo autorizimet e tij, me dashje ka kryer veprën penale nga neni 141 paragrafi 2 i Kodit Penal të Kosovës, duke nxitur dhe përhapur publikisht urrejtje, përçarje dhe mosdurim midis grupeve kombëtare, racore dhe etnike që jetojnë në Republikën e Kosovës.

Kjo për shkak se me datë 24 mars 2019 në cilësinë e pjesëmarësit dhe folësit në tubimin

qytetarkundër intervenimit të NATO-s, i akuzuari është shprehur se: *"Arsyeja për agresionin në shtetin tonë ka qenë e ashtuquajtura katastrofë humanitare në Kosovë e Metohi...Masakra e Reçakut ishte trillim...Janë terroristet shqiptarë që e trilluan gjithë këtë dhe bënë krimet më të mëdha në Kosovë e Metohi...Për këtë, sot e kësaj dite askush nuk ka dhënë përgjegjësi...Kanë bërë krime para agresionit të NATO-s, kanë vrarë shtëpiakë të mirë serb dhe polic në vendin e tyre të punës...gjakpirjen e tyre e kanë vazhduar edhe gjatë agresionit edhe pas ardhjes të se ashtuquajtures mision paqësor në Kosovë e Metohi",* veprime këto të cilat mund të prishin rendin publik ose të shkaktojnë pasoja tjera më të rënda në Republikën e Kosovës.

¹² Gjykata Themelore në Prishtinë, PS. nr. 20/19, https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/PR_PKR_20_19_SO.pdf

Andaj, duke u bazuar në prova të ndryshme materiale: dëgjimi dhe shiqimi i videoinqizimit, shkrimet e botuara në portale dhe gazeta të ndryshme, Gjykata i shqiptoi dënime me burgim në kohëzgjatje prej 2 viteve.

Në anen tjetër mbrojtja pretendonte se në këtë rast nuk plotësoheshin 'kushtet ligjore për ekzistimin e veprës penale, sepse në paragrafin 1 të nenit 147 është e nevojshme që veprimi inkriminues ta rrezikoj rendin publik, e që në rastin konkret kjo nuk ka ndodhur..., nuk ka pasur asnjë tubim publik, demonstrata në rrugë, bllokime të rrugëve apo të ngjashme.' Si dhe klienti i saj 'nuk e ka keqpërdorë detyrën zyrtare sepse edhe pse në atë kohë ka qenë ministër, ai ka mundur të ju drejtohet qytetarëve si qytetar në kapacitet individual dhe se mund të flasë në çfarëdo tubimi si qytetar, sepse po t'i drejtohej tubimit në cilësi të ministrit, me siguri ai do të kishte kërkuar nga

kryetari i Qeverisë që të shkoj atje të flas, apo kishte kërkuar urdhër për veturë zyrtare dhe do të kërkonte mëditje për punë ditën e dielë, asnjë nga këto nuk kanë ndodhur.'

Duke pasur parasysh këto pretendime, avokati i të pandehurit ka atakuar me ankesë aktgjykimin e shkallës së parë, duke kërkuar nga Gjykata e Apelit që klientin e tij t'a shpallë të pafajshëm pasi që veprimi për të cilin akuzohet i pandehuri është liria e shprehjes, e cila mbrohet me nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).¹³

Gjithashtu mbrojtja konsideron se nuk mund të procedohet tutje për shkak të pengesave procedurale, ngase I.T është deputet, dhe si i tillë ka imunitet nga ndjekja penale. Seanca është duke vazhduar.¹⁴

3.4.1. Analizë nëse ka ekzistuar gjuha e urrejtjes

Ky rast e gjen vetën në një linjë gjykimesh me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të drejtuara midis kontrastit për kriminalizimin e mohimit të gjenocidit në njërin anë dhe mbrojtjen e lirisë së shprehjes në anën tjetër.

Siç dihet, Neni 10 i KEDNJ, thotë se çdokush ka të drejtë të ketë opinione dhe të marrë informacion 'pa ndërhyrje nga autoritetet publike dhe pavarësisht nga kufijtë'. Paragrafi i dytë i dispozitës imponon disa kufizime në ushtrimin e kësaj lirie që mund t'i nënshtrohen "formalitetëve, kushteve, kufizimeve ose ndëshkimeve të përcaktuara me ligj dhe janë

të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, territoriale, integritetit ose sigurisë publike, për parandalimin e çrregullimit ose krimin, për mbrojtjen e shëndetit ose moralit, për mbrojtjen e reputacionit ose të drejtave të tjerëve, për parandalimin e zbulimit të informacionit të marrë në konfidencë, ose për ruajtjen e autoritetit dhe paanësisë së gjyqësori."

Interpretimi tradicional i Nenit 10, i dhënë nga Gjykata Evropiane, ishte mjaft i ngurtë në lidhje me përcaktimin dhe zbatimin e kufizimeve të përmendura, duke marrë parasysh rolin themelor të lirisë së shprehjes në një shoqëri

13 <https://betimiperdrejtesi.com/deputeti-qe-u-denua-per-deklaratat-e-tij-fyese-per-masakren-e-recakut-kerkon-pafajesine-ne-apel-prokuroria-kerkon-te-refuzohet-ankesa-e-tij/>

14 <https://betimiperdrejtesi.com/avokati-thote-se-ceshtja-penale-ndaj-deputetit-ivan-todosijeviq-nuk-mund-te-vazhdoje-tutje-pasi-i-njeiti-ka-imunitet-ndaj-ndjekjes-penale/>

demokratike dhe karakterin e jashtëzakonshëm që duhet të marrin kufizimet.¹⁵

Përkundër këtij trendi të përgjithshëm – për mbrojtjen e lirisë së fjalës – Gjykata ka treguar një qasje të ndryshme në vendimet në lidhje me mohimin e Holokaustit, në të cilat kufizimet në të drejtën e mbrojtur nga Neni 10 u justifikuan përmes nevojës për të mbrojtur vlerat e tjera themelore, të tilla si drejtësia dhe paqja,¹⁶ nderi dhe reputacioni.¹⁷ Në fakt, Gjykata gjeti se dënimet penale të nxjerra nga gjykatat kombëtare kundër mohuesëve të gjenocidit ishin në përputhje me Konventën, me arsyetimin se nuk mund të thirret një person në një të drejtë themelore për të kryer një veprim të destinuar për të shkatërruar të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Konventa.

Mohimi i Holokaustit është konsideruar nga Gjykata si një fenomen shumë shkatërrues i strukturës shoqërore, i rrezikshëm për rendin publik dhe për kohezionin midis grupeve. Gjykata e konsideroi atë në kontrast me drejtësinë dhe paqen – të dyja, vlera të mbrojtura nga konventa – dhe për këtë arsye nuk meritojnë asnjë mbrojtje.¹⁸

Në veçanti, në çështjen *Marais kundër Francës*, kundërshtimi i ekzistencës së krimeve kundër njerëzimit u gjykua si një përpjekje për të fshirë kujtesën e viktimave të nazizmit dhe dëmtuar reputacionin e të tjerëve. Këto deklarata morën një përkufizim të plotë në çështjen *Garaudy kundër Francës*, në të cilën Gjykata shkoi më tej duke thënë se “*mohimi i krimeve kundër njerëzimit është një nga format më serioze të shpifjes racore kundrejt hebrenjve dhe nxitjes së urrejtjes ndaj tyre*”. Liria e shprehjes nuk mund të ushtrohet në lidhje me ngjarjet historike, të vërtetuara dhe të përcaktuara si

Holokausti. Prandaj ‘*mohimi i Holokaustit nuk mund të konsiderohet si produkt i kërkimit shkencor, sepse ai ka për qëllim të rivendosë regjimin nazist, duke akuzuar viktimat e Holokaustit për keqpërfaqësim.*’ ‘*Ai bie ndesh me demokracinë, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të mbrojtura nga Konventa*’.

Sidoqoftë në rastin *Perinçek*,¹⁹ Gjykata konsideroi se me dënimin me burg të një politikani turk i cili në fjalimet e tij në Zvicërr, vazhdimisht proklamonte se gjenocidi armen nuk ka ndodhur, kishte shkelur lirinë e tij të shprehjes, duke thënë se se nuk kishte asnjë indikacion se deklaratat e z. Perinçek kishte të ngjarë të ngjallnin urrejtje ose dhunë, duke nënvizuar se ekziston një ndryshim i madh midis nxitjes së dhunës dhe deklaratave që thjesht mohojnë një gjenocid, sepse ato nuk kanë të njëjtat implikime dhe të njëjtat pasoja. Për këtë arsye, Gjykata deklaroi se dënimi penal nuk dukej ‘i nevojshëm në një shoqëri demokratike’.

Rrjedhimisht, duke krahasur këtë analogji të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, shohim se çështja në fjalë, është trajtuar nga Gjykata Evropiane në një mënyrë të tillë, në të cilën dallimi është një fije e hollë e interpretimit nëse dënimi ka qenë në pajtim me garancitë për mbrojtjen e lirisë së shprehjes.

Në këtë kuptim ne do të vlerësojmë nëse deklaratat e të pandehurit z. Teodosijeviq, mund të karakterizohen si lloji i shprehjeve që kanë të drejtë për mbrojtje të shtuar ose të zvogëluar sipas nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Para së gjithash, duhet të sqarohet nëse këto deklarata a ishin të një natyre historike, juridike dhe politike: a foli si politikan, apo si një studiues historik ose juridik.

15 *Sunday Times v United Kingdom* App no 6538/74 (ECtHR, 26 prill 1979); *Vogt v Germany* App no 1785/91 (ECtHR, 2 shtator 1976).

16 *T v Belgium* App no 9777/82 (Commission Decision, 14 korrik 1983).

17 *X v Federal Republic of Germany* App no 9235/81 (Commission Decision, 16 korrik 1982).

18 *H, W, P and K v Austria*, App no 12774/87 (Commission Decision, 12 tetor 1989); *Walendy v Germany* App no 21128/92 (Commission Decision, 7 janar 1992); *P v Germany* App no 19459/92 (Commission Decision, 20 mars 1993); *Otto EFA Remer v Germany* App no 25096/94 (Commission Decision, 6 shtator 1995); *Gert Honsik v Austria* App no 25062/94 (Commission Decision, 18 tetor 1995); *DI v Germany* App no 26551/95 (Commission Decision, 26 qershor 1996).

19 *Perinçek v Switzerland* App no 27510/08 (ECtHR, 17 dhjetor 2013).

Në këtë kuptim z. Teodosijeviq, foli në një tubim në cilësi të Ministrit të Republikës së Kosovës, pavarësisht se ai konsideron që ka folur si person fizik, në momentin që i adresohet një mase të gjërë të popullit, një person i cili bart autoritet të lartë, si ai i ministrit, është dashur të dijë që perceptimi i publikut është që ai po flet në cilësi zyrtare..

Së dyti, në kuptim të kontekstit gjeografik dhe kohor, midis deklaratës së të pandehurit dhe ngjarjeve të cilat ai u referohet kanë kaluar vetëm 20 vite, dhe sidomos kur këto kujtime janë ende të freskta, ndërsa tmerri i luftës së përjetuar është i drejtëpërdrejt pasi ato direkt janë shkaktuar, pikërisht në vendin ku edhe janë bërë deklaratat, z. Todosojeviq, është dashur të distancohet nga mizoritë që janë kryer. Ndërsa në anën tjetër, te rasti i z. Perinçek nuk kishte një lidhje të drejtëpërdrejtë midis Zvicrës dhe ngjarjeve që ndodhën në Perandorinë Osmane. Për më tepër, kishte një kalim të konsiderueshëm të kohës midis deklaratave të kriminalizuara dhe gjenocidit të armenëve.

Ndërsa nëse e analizojmë deklaratën e të pandehurit, ai thekson se arsyeja për bom-

bardimin e shtetit të Serbisë është trillimi i Masakrës së Reçakut, duke shtuar se askush nuk ka marrë përgjegjësi për këtë. Kjo pjesë është nxitje për të ndërmarrë veprime, ndaj *"terroristeve shqiptarë që e trilluan gjithë këtë dhe bënë krimet më të mëdha në Kosovë e Metohi"*, në këtë kuptim ai i përcakton si terroristë dhe gjakpirës popullin shqiptar. Duke konsideruar që shqiptarët kanë trilluar masakrën e Reçakut, dhe se dëmet ndaj popullit serb ishin shkaktuar nga ky trillim, atëhere kjo përfaqëson një nga format më serioze të shpifjes e që në thelb nxit urrejtjen në bazë të përkatësisë etnike. Për më tepër këto deklarata thuhën nga një ministër, i cili me autoritetin e tij, impakti i deklaratave të tij janë të mëdhaja, sa që krijon një klimë të përçarjes në mes të etniteteve në Kosovë. Prandaj, mund të thuhet se rasti në fjalë paraqet një rast tipik të përdorimit të gjuhës së urrejtjes, sepse konteksti, nuk ishte thjesht një deklaratë e bazuar në ndonjë fakt nëse masakra e Reçakut, ka ndodhur apo jo; por deklarata ishte e tillë që nxiste urrejtje, sepse theksonte që për shkak të kinse trillimit të masakrës së Reçakut i cili është bërë nga i tërë populli shqiptar, populli serb është bombarduar.

3.5. NXITJA E URREJTJES NË RRJETE SOCIALE NË PEJË ²⁰

Më 11.06.2020 Prokuroria Themelore e Pejës ka ngritur aktakuzë ndaj të pandehurit V.M për shkak të veprës penale nxitja e përçarjes dhe mos durimit, nga neni 141 par.1të KPRK-së. I pandehuri, më datë 08.10.2019, rreth orës 20:00, përmes rrjetit social nxit dhe përhap publikisht urrejtje, përçarje dhe mos durim midis grupeve etnike në atë mënyrë që, i pan-

dehuri, në kohën vendin e lartcekur, komenton një foto në të cilën kishte dalë zyrtari policor S. K., me fjalët: *"Pse dreqin nuk po e qitni një fotografi të shqiptarit po të boshnjakut, dreqin e pse nuk e fotografon A., ose dikë tjetër po këtë qen që me shtrydh mirë(9) nëntë shkije i pjell po kur shqiptar nuk arrit...shajeni ni shka e kqyrne çka ndodh e ju krah me m..."*.

Gjatë seancës gjyqësore, i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, duke shtuar se ndihet i penduar, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra penale, me të dëmtuarin nuk kanë më ndonjë mosmarrëveshje, dhe i ka kërkuar falje të dëmtuarit.

Me provat e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit V. M. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale, nxitja e

përçarjes dhe mos durimit. Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës. Sa i përket fajësisë i pandehuri veprën e kryer, e ka kryer me dashje.

Andaj, të pandehurit i shqiptoi dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, mirëpo ky dënim nuk do të ekzekutohet në rast se i pandehuri brenda periudhës 1 (një) vjeçare nuk kryen ndonjë vepër të re penale.²¹

3.5.1 Analizë nëse ka ekzistuar gjuha e urrejtjes

Në rastin në fjalë gjykata ndonëse nuk e analizën, kontekstin, qëllimin apo përmbajtjen e deklaratës, vendos saktë në dispozitiv lidhur me konstatimin e gjuhës së urrejtjes dhe dënimin.

Kjo për arsye se ndonëse i pandehuri, komenton në një foto, në cilësi personale, për ta parafrazuar, ai deklaroi, që pse është publikuar një fotografi e një polici boshnjak dhe se

ky është qen, e po ta shtrydhësh i lind 9 shkije, por shqiptar jo. Ndërsa bën thirrje që ta shajnë një 'shka', e pastaj të shikohet çka ndodh. Sipas kësaj, i pandehuri i nxit të tjerët për të sharë, 'shkiet [titull provokativ, për personat e përkatësisë etnike serbe]', prandaj kjo në vetë përbën gjuhë të urrejtjes e drejtuar ndaj personave të përkatësisë etnike serbe, dhe nxitje për urrejtje ndaj tyre, në mënyrë të tillë që bëhet thirrje për t'i sharë ata.

3.6. NXITJA E URREJTJES GJATË FESTËS SË VIDOVDANIT NË GAZIMESTAN

Në këtë pjesë është trajtuar rasti i të akuzuarit Risto Jovanović, shtetas i Malit të Zi, i cili është shpallur fajtor nga Gjykata e Prishtinës, për shkak të veprës penale 'nxitje e përçarjes dhe e mosdurimit'. Jovanović akuzohet se më 28 qershor 2021, rreth orës 14:00 në fshatin

Mazgit, Komuna e Obiliqit, respektivisht tek monumenti i "Gazimestanit", me dashje ka nxitur dhe përhapur publikisht urrejtje, përçarje dhe mos durim mes grupeve etnike dhe fetare që jetojnë në territorin e Republikës së Kosovës, në atë mënyrë që gjatë manifestimit

të përvjetorit të njohur si "Vidovdan", publikisht dhe në prezencën e numrit të konsiderueshëm të qytetarëve, ka brohoritur fjalët "vrite shqiptarin", "Kosovën do ta lajm me gjak", "Kosova është Serbi". Ndërsa para gazetarëve dhe medieve të pranishme ka deklaruar " ... kur kthehem djathtas, ku shoh shqiptarët, atyre do tu

vie ngusht, për neve do jetë më mirë ... me çka ka përhapur publikisht urrejtje duke rrezikuar prishjen e rendit publik, dhe me këto veprime i pandehuri ka kryer veprën penale nga neni 141 i Kodit Penal të Kosovës, "Nxitje e urrejtjes, përçarjes dhe e mos durimit".

3.6.1. Analizë nëse ka ekzistuar gjuha e urrejtjes

Në këtë rast, Gjykata ka vlerësuar drejt se i pandehuri ka përdorur gjuhë të urrejtjes. Kjo sepse i pandehuri R.J. duke brohoritur publikisht fjalët "vrite shqiptarin", "Kosovën do ta lajm me gjak", "Kosova është Serbi", si dhe me deklarimin e tij para gazetarëve dhe medieve të pranishme " ... kur kthehem djathtas, ku shoh shqiptarët, atyre do tu vie ngusht, për neve do jetë më mire ... duke ju referuar me emrin *Šiptari*, i vetëdijshtë se përdorimi i termit *Šiptari* është ofensiv dhe diskriminues dhe i vetëdijshtë për kontekstin historik të vendit ka përhapur publikisht urrejtje duke rrezikuar prishjen e rendit publik, sepse në një situatë të tillë ekziston mundësia reale që të nxitet masa dhe të eskaloj situata me pasoja të paparashikuara.

Pretendimi për t'i ikur përgjegjësisë penale duke u arsyetuar në shqyrtim gjyqësor se ka deklaruar se "atyre - duke menduar për serbët, me shqiptaret do tu jetë ngusht" ka menduar në pozitën e vështirë të serbëve në Kosovë, gjykata kishte vlerësuar se i njëjti edhe në këtë mënyrë shfaq urrejtje ndaj një grupi etnik shqiptar dhe i paraqet si të rrezikshëm dhe kërcënues për grupin etnik serb në Republikën e Kosovës. Prandaj sipas Gjykatës i pandehuri konsiderohet penalisht përgjegjës për sjelljet dhe veprimet e tij për të cilat gjykata e shpalli fajtor dhe e dënoj sipas ligjit.

3.7. RASTI I GJUHËS SË URREJTJES NË KOMUNËN E NOVOBËRDËS

Gjykata Themelore në Gjiilan kishte ngritur aktakuzë ndaj të akuzuarit Srgjan Ivkovic nga fshati Izvor. Ai ishte shpallur fajtor nga Gjykata me arsyetimin se më 29.03.2010, rreth ores 10:15, në fshatin Boston, Komuna e Novobërdës, në objektin e komunës së Novobërdës, e me qëllim të nxitjes dhe përhapjes në mënyrë publike të urrejtjes dhe përçarjes etnike të grupeve tjera etnike – kombëtare që jetojnë në Kosovë, në atë mënyrë që ka hyrë në objektin e komunës në fjalë dhe i është drejtuar punëtorit të sigurimit Rr.M me fjalët përçarëse dhe urrejtëse: "ma mirë kishte qenë që këtu të

ishte sërbia se kishim pas ma shumë liri dhe keni me parë se përsëri sërbia do të kthehet me tanke në Kosovë si në vitet 1988/99 dhe kemi me ja u bë ma zi" dhe ka vazhduar duke sharë policinë e Kosovës dhe institucionet e Kosovës, me çka ka prishur rendin publik dhe sigurinë publike në shtetin e Kosovës, prandaj i lartëcekuri ka kryerë veprën penale 'nxitja e urrejtjes, e përçarjes ose e mos durimit kombëtar, racor, fetar, etnik nga neni 115 paragrafi 1 të KPK-së'. Andaj gjykata, i shqipton, dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, me kusht që i akuzuari brenda afatit

prej 2 (dy) viteve, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi mos të kryejnë vepër tjetër

penale, në të kundërtën dënimi ka për t'ju revokuar.²²

Analizë nëse ka ekzistuar gjuha e urrejtjes

Rasti në fjalë paraqet një situatë komplekse juridike lidhur me atë nëse vepra në fjalë përbën thjesht vepër kundërvajtse ashtu që duke përdorur fjalë ofenduese, ka pasur për qëllim të provokoj prishjen e rendit dhe qetësisë publike, apo ajo mund të konsiderohet edhe si vepër penale, në kuptim të nxitjes së urrejtjes dhe përçarjes mbi baza etnike.

Pra, padyshim që rasti në fjalë përbën vepër kundërvajtse e sanksionuar nga neni 5 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 03/L-142 për Rendin dhe Qetësinë Publike, sepse në mënyrën se si është shprehur personi në fjalë – duke pasur parasysh kontekstin historik të regjimit të të Serbisë – ka mundur të provokoj reagimin e personave ndaj të cilëve i është drejtuar, ashtu që të provokoj prishjen e rendit dhe qetësisë publike.

Nëse e shohim kontekstin, personi është i përkatësisë etnike serbe dhe ai këto fjalë i përdorë në objektin e komunës në një vend publik, dhe fakti që ai përdor shprehjen “*kemi me ja u bë*

ma zi”, konsiderohet se ai ndërlidh përkatësinë e tij e etnike serbe me fjalët që i thotë. Në këtë kuptim ai nuk jep një opinion lidhur me atë nëse gjatë kohës së okupimit serb ka pasur më shumë liri apo jo. Por duke ndërlidhur përkatësinë e tij etnike përmes fjalëve “*kemi me ja u bë ma zi*” ai këtë e mendon si serbët kanë me ja u bë ma zi. Një shprehje e tillë, nxit urrejtjen dhe përçarje, ashtu që pasojat e mundshme kanë mundur të jenë tejet të rrezikshme. Kjo sepse të drejtuarit me fjalë të tilla ndaj personit zyrtar ka pasur për tendencë të ngjallë reagimin e tij, në mënyrë që ky reagim i tij do të mund të perceptohej si i bërë mbi baza etnike. Rrjedhimisht, rreziku i shkaktimit të nxitjes së urrejtjes brenda një komuniteti të vogël shumë-etnik si i komunës së Novobërdës ka qenë mjaft i madh. Prandaj duke pasur parasysh se shprehja bëhet në vend publik në komunë, dhe me qëllim të tillë që të i mëvesh fjalët e tij, në një kuptim të tillë që personat e përkatësisë etnike serbe do ja bëjnë më zi personave të përkatësisë etnike shqiptare, kjo përbën gjuhë të urrejtjes.²³

3.8. Rasti i gjuhës së urrejtjes përmes veprave letrare

H.M akuzohet se më 12 gusht 2021, në Gjakovë, gjatë promovimit të librit të tij, nxit dhe publikisht përhap urrejtje dhe përçarje. I akuzuari

nga Gjykata Themelore në Gjakovë u dënua dënim me burg në kohëzgjatje prej 150 ditësh, por i njëjti u zevëndësua me dënim me gjobë

²² https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/GJ_P_1133_15_SQ.pdf - faqe 43,43.

²³ https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/GJ_P_1133_15_SQ.pdf

me vlerë 2 mijë euro. Kjo sepse sipas aktgjyqimit, i akuzuari H. M. nga Gjakova, me banim në Austri është fajtor sepse me datën 12.08.2021, në Gjakovë, nxit dhe përhap publikisht urrejtje, përçarje dhe mos durim midis grupeve kombëtare turke dhe shqiptare, si dhe midis komunitetit fetar mysliman dhe të krishterë, në mënyrën e cila mund ta prish rendin publik, në atë mënyrë që i pandehuri pasi boton librin me titull "Bubullimë e shpirtit", të njëjtin e promovon në një organizim të mbajtur në Hotel , ku në përmbajtjen e këtij libri në fq.114-115, 181-182, 195-196, janë të shkruara poezitë me titull "Qohu Enver", "Shporruni njëherë e përgjithmonë" dhe "Msitnia", e të cilat kanë përmbajtje të urrejtjes fetare dhe kombëtare ndër te tjera si: *"Qohu nga varri, ti Enver, se s'na*

*mbet ma fytyrë as nderë, qohu rrënojë ti këto xhami që i kanë ndërtuar shpi për shpi, qohu ti lidhju duar e gishta, e ja u kthe xhamit në kisha, se janë mbush me talibanë, nuk njohin as babë as nanë", "Shporru o turk m** njëherë e përgjithmonë nga trojet e mia, shporru o të huptë fara e mos të mbete as gruaja e as fëmija", "paj tërmeti ardh t'apet, rrafsh me tokë e baft përpjetë, kurrë për jetë mos paçin shpi, këtu s'do të ketë ma asnjë xhami", "Baba Sheh qofsh mallkuar tash për atëherë, varri eshtrat ty brenda mos ti lasht, vajzat tua bukur i ke rrahatur, kurrë mos paqin pranverë, hijenat eshtrat ti nxjerrshin jashtë" , ku me këto veprime i pandehuri ka mundur të prish rendin publik në Republikën e Kosovës.*

Analizë nëse ka ekzistuar gjuha e urrejtjes

Në këtë situatë kemi të bëjmë me një rast tipik të gjuhës së urrejtjes. Kjo sepse i pandehuri përdor një forum publik e poashtu përmes botimeve të tij nxit urrejtje ndaj komunitetit musliman, ku jo vetëm ofendon ata, por ndaj tyre bëhet thirrje që të ushtrohet dhunë. Kjo thirrje nuk kufizohet vetëm në dhunë, por edhe në përdorim të fjalorit denigrues e poshtrues deri në atë masë sa bëhet thirrje për shfarosje të këtij komuniteti në përgjithësi.

4. KANOSJA SI KRIMI URREJTJES DHE MONITORIMI I PUNËS SË POLICISË DHE PROKURORISË LIDHUR ME KËTË VEPËR

Rastet në vijim paraqesin një formë mjaft të shpeshtë të krimit të urrejtjes. Siç thamë më herët, për një vepër të konsiderohet krim i urrejtjes, duhet që akti i kryer të përbëj vepër penale sipas të drejtës pozitive penale dhe të jetë motivuar nga një paragjykim. Në këtë kuptim, të gjitha rastet e monitoruara më poshtë, përbëjnë krim të urrejtjes dhe përmbushin elementet e veprës penale të 'kanosjes' e sanksionuar nga neni 181 i Kodit Penal të Kosovës. Siç do e shohim, këto kanosje kanë ndodhur për shkak të paragjyimit të kryersit ndaj viktimave për shkak të lidhjes së tyre reale ose të perceptuar, përkatësisë ose mbështetjes së një grupi të mbrojtur në bazë të orientimit të tyre seksual. Në këtë aspekt, tek rasti i kanosjes, kryerja e veprës penale nga urrejtja nuk është element juridik i kësaj vepër penale, por një rrethanë e kërkuar rënduese siç përcaktohet shprehimisht me kodin penal në nenin 70. Me fjalë të tjera, kur llogaritet dënimi për kryersin, me rastin e provimit se vepra është është kry-

er nga paragjykimi, gjykata duhet ta marr këtë në konsideratë si një rrethanë rënduese, ashtu që dënimi të jetë më i lartë.

Nga rastet e monitoruara mund të shohim, poashtu se policia gjatë hetimit të rasteve se nëse është konsumuar vepra penale, nuk i kanë ndërmarrë të gjitha hapat e arsyeshëm për të demaskuar çdo motiv i cili mund të jetë paragjykes ndaj orientimit seksual. Policia duhet që të drejtojë aktivitetet hetuese, përveç gjetjes së autorit dhe provave të asaj që është bërë vepra penale, edhe për gjetjen e provave të një *motivimi të njëanshëm mbi baza diskriminuese* që paraqitet si arsye për kryerjen e veprës penale, e cila në procedurën e mëvonshme mund të shërbejë si bazë për kualifikimin si rrethanë rënduese për dënimin. Policia duhet të ndërmarrë veprime të tilla pavarësisht nga raporti i palës së dëmtuar dhe vlerësimi i tij nëse ekziston apo jo një bazë e tillë.

4.1. Monitorimi i Policisë së Kosovës -Stacioni Qendra

Me datën 2 maj 2021, është raportuar një rast nga L.M kundër një grup personash nga

të cilët njëri prej tyre kishte pshtyer ne fytyre raportuesin, dhe e kishte kërcenuar me vras-

je me pas. Menjëherë pas incidentit, viktimat është nisur tek stacioni policor përgjegjës për atë zonë, e cila ishte e rrethuar me kamera të ndryshme publike dhe private të bizneseve.

Më tutje, Policia e Kosovës – Stacioni Qendra ka vazhduar me hetimet lidhur me rastin, ne ç'rast kanë kontaktuar viktimën duke njoftuar atë se personi nuk mund të identifikohet përmes kamerave.

Në një takim me shefin e hetuesisë gjatë monitorimit të rasteve të krimit të urrejtjes, viktimat është njoftuar se rasti është ende në hetime që nga muaji maj dhe se ende nuk është identifikuar personi.

Pyetjet të cilat janë parashtuar për shefin e hetuesve lidhur me këtë rast:

- A janë monitoruar të gjitha kamerat e sigurisë?
- Pasi që viktimat është njoftuar që nuk po arrihet të identifikohet personi, përse nuk është ftuar viktimat për bashkëpunim, edhe pse viktimat e kishte kërkuar këtë opion?

- Viktimat është pshtyer në fytyrë gjatë kohës së pandemisë. A e keni cilësuar edhe si shkelje të rregullave dhe ligjeve për parandalimin e COVID-19?
- Cilat janë hapat e mëtutjeshëm?

Shefi i hetuesisë në takim ka njoftuar që të gjitha kamerat janë monitoruar, duke theksuar se disa prej tyre me gjasë nuk janë paguar nga bizneset dhe nuk kanë qenë në funksion realisht. Kjo çështje nuk është vërtetuar nga ana e Policisë së Kosovës. Arsyetimi se përse nuk është kontaktuar viktimat për të bashkëpunuar në identifikimin e personave të cilët janë kapur në disa nga kamerat, ishte se hetuesja ishte në pushim për shkak të shtatëzanisë. Shefi i hetuesve gjithashtu ka theksuar se pështyma e viktimes nuk do të cilësohet si rrezik i shtuar pa u testuar dhe vërtetuar se sulmuesi rezulton pozitiv në testin e COVID-19.

Në fund është thënë se rasti do të vazhdojë të hetohet më tutje dhe do të tentojnë të identifikojnë personin. Policia e Kosovës ka shtuar se do të informohemi për hapa të mëtutjeshëm që do të ndërmerren ndaj personave pas hetimeve dhe rasti do të dergohet në Prokurorinë Themelore.

4.2. Monitorimi i Policisë së Kosovës – Stacioni Qendra

Me datë 01 korrik 2021, L.M ka raportuar në Stacionin Policor Qendra se është kërcënuar nga një individ përmes rrjeteve sociale. Arsyeja e kanosjes ishte reagimi i L.M pas ftesës në debat në emisionin Debat+, ku pjesë e emisionit ishte dhe një Imam/Hoxhë.

Viktimat ka refuzuar të jetë pjesë e këtij emisionit duke e quajtur nxitje të urrejtjes ftesën në një debat të tillë duke parashikuar lehtë situatën në vazhdim. Pas refuzimit, L.M kishte reaguar publikisht përmes rrjetit social Face-

book, duke theksuar se *"...një hoxhë nuk mund t'i vë në diskutim të drejtat e njeriut në një shtet demokratik"*. Ky shkrim në facebook ka ngritur reagime të shumta të individëve besimtar, ku në mesin e tyre njëri nga ta ka filluar të kërcënoj viktimën përmes rrjeteve sociale.

Pyetjet e parashtuara për shefin e hetuesve:

- A është identifikuar personi, pasi që rrjetet sociale kanë qenë me profil real?

- Si është cilësuar rasti dhe a e keni konsideruar krim të urrejtjes në bazë të orientimit seksual?
- A është marrë në pyetje personi?

Lidhur me këtë rast Policia e Kosovës nuk ka ofruar shumë informata. Personi në fjalë është identifikuar nga Policia e Kosovës dhe

është momentalisht jashtë vendit. Ai ka lajmëruar Policinë e Kosovës se do të shkoj në mënyrë vullnetare në stacion sapo të kthehet në Kosovë pasi që e ka momentalisht të pamundur të kthehet. Rasti është cilësuar si Kanosje dhe nuk është dhënë ndonjë detaj tjetër sa i përket këtij rasti. Personi pritet të jap deklaratë pasi që të kthehet në Kosovë.

4.3. Monitorimi i Prokurorisë Themelore – Prishtinë

Emira Murati gjatë Javës së Krenarisë ka lansuar projektin e financuar nga organizata CEL Kosova, në të cilën është paraqitur një çift gej me rroba kombëtare, duke simbolizuar se personat LGBTI kanë egzistuar gjithmonë në të gjitha shtetet, duke përfshirë persona tradicional.

Kjo pikturë ka ngritur reagime të shumta nga një masë e gjerë, duke sulmuar direkt edhe krijuesen e pikturës. Disa nga këto raste janë raportuar në Policinë e Kosovës – Stacioni Jug dhe sipas informatave të Prokurorisë Themelore të Prishtinës rasti është cilësuar si Kanosje.

Eksperienca e Ermira Muratit gjatë raportimit të rastit ka qenë e parehatshme dhe ajo ka thënë se: *“Ka pasur dy qasje të ndryshme nga policia; në stacionin Qendra, qasja ka qenë neutrale dhe vetëm me qëllim të marrjes së informatave. Pas transferimit të Stacioni Jug, qasja e disa prej zyrtareve ka qenë gjykuese, gjate kontaktit ka pasur shprehje të tilla si: “Nuk esht dashte me e bo kta”, “Ke perdhos veshjet kombetare”.*

Dhe se:

“Sjellja e zyrtarit policor intervistues, Liridonit, ka qenë pergjithesisht e mire. E ka ndegju rastin dhe ka ofruar keshilla. Vlen ta veçoj rastin

kur ka thene: “egziston ligji per nxitje te urrejtjes, duhet me pas kujdes se mundet me u kthly kunder teje vepra”.

Zyrtaret policor me detyre me te ulet qe kam pasur kontakt te shpejte dhe te paket, kryesisht kane pasur mendime jo-pozitive ndaj rastit.

Liridoni, zyrtar me pozite me larte, ka pasur sjellje me pozitive pervec rastit te lartepemendur.”

Ndërsa më pas është kontaktuar edhe Prokuroria Themelore e Kosovës lidhur me rastin e lartëpërmendur dhe ka treguar që me datë 24.08.2021 është ngritur aktakuzë ndaj një (1) personi, në drejtim të veprës penale “Kanosja” sipas KPRK-së.

Prokuroria Themelore në Prishtinë nuk ka shtuar ndonjë informatë tjetër dhe momentalisht ju janë dërguar pyetje shtesë lidhur me këtë rast.

4.4 Monitorimi i Prokurorisë Themelore – Prishtinë

Në muajin dhjetor të vitit 2019, organizata CEL Kosova ka pranuar thirrje në telefonin zyrtëtar nga një individ i panjohur duke tentuar të marr informata rreth organizates dhe lokacionit të organizatës. Më tutje organizata CEL Kosova ka mësuar që individ i cili ka telefonuar ishte prindi i një personi të komunitetit LGBTI. Prindi i personit kishte kërcënuar se do të demtoj orgaizatën dhe pjestarët e organizatës CEL, duke kërcënuar për sulm fizik.

Rasti është paraqitur në Stacionin Policor Qendra nga përfaqësuesi i organizatës CEL Kosova B.M. Më tutje, Policia e Kosovës ka identifikuar personin dhe rasti është drejtuar tek Prokuroria Themelore në Prishtinë.

Pas intervistimit të B.M, theksohet se nuk ka pranuar ndonjë informatë pas kontaktimit të

fundit me prokurorine, në ç’rast raportuesi nuk pret se do të zbardhet ky rast.

Prokuroria Themelore në Prishtinë është kontaktuar për rastin në fjale, duke i kërkuar më shumë informata rreth rastit dhe se si do të trajtohet ky rast më tutje.

Me pas, prokuroria themelore në Prishtinë ka ofruar shumë pak informata sa i përket këtij rasti duke thënë se Prokuroria ka ngritur aktakuzë ndaj një (1) personi, në drejtim të veprës penale “Kanosja” sipas KPRK-së.

Prokurorisë u janë parashtuar kerkesa shtesë për informata të detajuara lidhur me rastin dhe jemi në pritje të pergjigjeve.

4.5. Monitorimi i Prokurorisë Themelore – Prishtinë

Në stacionin policor qendra është kërkuar informata për rastin 2017-AB-3184 për disa kërcënime drejt një aktivisti për të drejtat e komunitetit LGBTI në Kosovë, në ç’rast motivi ka qenë dukshmëria e këtij komuniteti gjatë javës së krenarisë 2017. Gjatë kësaj periudhe, aktivisti L.M ka pranuar mbi 150 kërcënime, për të cilat është bërë e ditur tek stacioni i policisë Qendra në Prishtinë.

Pas raportimit të kërcënimeve, L.M i është kërkuar të përzgjedh disa nga kërcënimet të cilat cilësohen më serioze, duke gjykuar se disa raste mund të mos paraqesin rrezik.

L.M është pyetur nga Policia e Kosovës nëse po ndihet i rrezikuar, ku ishte përgjigjur me “PO”. Më tutje, L.M është kontaktuar nga Poli-

cia e Kosovës duke njoftuar që është shumë e vështirë të identifikohen këta persona pasi që janë me profile të rrejshme dhe identitete të fshehura.

Rastet e Javës së Krenarisë të vitit 2017 janë përcjellur në prokurori dhe pala nuk është njoftuar asnjëherë se çfarë po ndodh me këto raste. Kur është pyetur shefi i hetuesve se përse pala nuk është njoftuar për informata shtesë lidhur me rastin, nuk kemi pranuar ndonjë përgjigje të qartë.

Më tutje, është kontaktuar Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe është kërkuar informatë shtese lidhur me rastin dhe një raport për të cilin na ka njoftuar shefi i hetuesve F.Sh mirëpo nuk e kemi pranuar gjatë monitorimit.

4.6. Monitorimi i Prokurorisë Themelore – Gjilan

Në mars të vitit 2020, L.M është kanosur në rrjetet sociale nga një person për shkak të orientimit seksual, duke premtuar që do të perdor dhunë fizike sapo të takohen në rrugë. Kanosja ka ndodhur në rrjetin social "Instagram" me profil te vërtetë, dhe më pas rasti është raportuar në Policinë e Kosovës, stacioni Qendra. Policia e Kosovës ka procesuar lëndën në Prokurorinë Themelore të Gjilanit, e cila ka kontaktuar viktimen në muajin mars të vitit 2020.

Prokuroria Themelore në Gjilan ka konstatuar që raportimi i këtij rasti është krim i urrejtjes në bazë të orientimit seksual të viktimes. Gjatë takimit informues me prokurorinë themelore në Gjilan, viktimë është njoftuar që agresori është kontaktuar nga Prokuroria Themelore

në Gjilan, me ç'rast është bërë e ditur që personi në fjalë është i mitur dhe është kontaktuar edhe familja. Viktimë është pyetur se si dëshiron të procedoj me rastin duke pasë parasyshë që personi i cili kishte kërcënuar ishte i mitur.

Marrë parasyshë situatën, viktimë kishte tërhequr ankesën me kusht të edukohet personi i cili kishte kërcënuar palën lidhur me çështjet e të drejtave të njeriut nga prindërit. E ëma e tij ishte e përfshirë në shoqërinë civile për barazi gjinore dhe rasti është zgjidhur pa ndërhyrje të gjykatës deri më tash. Sidoqoftë, Prokuroria Themelore ka njoftuar që rasti është ende në proces. Viktimë nuk është kontaktuar më tutje lidhur me rastin në fjalë.

4.7. Monitorimi i Prokurorisë Themelore – Prishtinë

Viktimë ka raportuar rastin (Nr. i rastit: 2019-AB-1078) tek Policia e Kosovës për kanosje në rrjetet sociale, në bazë të orientimit seksual me datë 08.05.2019. Pas deklaratës në PK dhe hetimit të rastit, rasti është procesuar në Prokurorinë Themelore në Prishtinë me datë 23.07.2019. Prokuroria Themelore në Prishtinë ka ngritur aktakuzë ndaj një (1) personi në drejtim të veprës penale "Kanosja" sipas KPRK-së.

Ndërsa Policia e Kosovës është tërhequr për të dhënë informata të mëtutjeshme lidhur me rastin, duke konstatuar që puna e institucionit të Policisë së Kosovës është kryer dhe Prokuroria duhet të plotësoj monitorimin e këtij rasti.

Prokuroria Themelore në Prishtinë nuk ka ofruar mjaftueshëm informata lidhur me rastin në fjalë dhe ka thënë se rasti është ende në proces. Pas pyetjeve shtesë lidhur me rastin, PTHP ka përsëritur përgjigjen duke thënë:

"Ju njoftojmë edhe njëherë si në vijim, lidhur me rastet e parashtruara në kërkesën tuaj: Rasti me nr. 2019-AB-1078, është pranuar më 18.07.2019, ndërsa Prokuroria Themelore në Prishtinë, më 23.07.2019, ka ngritur aktakuzë ndaj një (1) personi, në drejtim të veprës penale "Kanosja", sipas KPRK-së."

5. Rasti i monitoruar në komunën e Mitrovicës: Dallimi në mes të diskriminimit dhe gjuhës apo krimit të urrejtjes

Rasti në fjalë ka të bëjë me një zyrtare në Zyrën për Komunitete dhe Kthim në Komunën e Mitrovicës. E.B e punësuar nga viti 2003, fillimisht në zyrën e UNMIK-ut, e pastaj në Komunën e Mitrovicës. Që nga koha e transferimit në kuadër të Komunës së Mitrovicës, E.B është vendosur në një zyrë të vetme në lagjen "2 Korriku", e shkëputur nga kolegët tjerë të Zyrës për Komunitete dhe Kthim, në mënyrë të tillë ashtu që ajo është ndjerë e vetmuar dhe e ndarë. Në Zyrën për Komunitete dhe Kthim në kuadër të Komunës së Mitrovicës, janë të punësuar 6 punëtorë. Ndër të punësuarit janë serb, boshnjak dhe të komunitetit turk. Në mesin e tyre ka qenë punëtorja në fjalë E.B, e cila ndonëse ishte vendosur në një zyrë të veçuar në një lagje tjetër nga kolegët tjerë, pas një kohë është larguar nga puna nga komisioni dicitplinor, pasi që ajo nuk e ka informuar mbikqyrësin e saj për mungesën e saj dy ditore, ashtu si kërkohet me Ligjin e Punës.

Sipas, Ligjit për Mbrojtjen kundër Diskriminimit, diskriminim do të thotë çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preference bazuar në karakteristikat personale të mbrojtura nga ligji, dhe të cilat kanë për qëllim apo efekt të zhvleftësoj ose cënoj njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës. Prandaj, situata në fjalë, paraqet një rast të mundshëm të diskriminimit, nëse vërtetohet nga gjykata që përshkak të përkatësisë etnike rome, e dëmtuara është trajtuar ndryshe ashtu që është vendosur në një zyre të veçantë, e më pastaj është pushuar nga puna.

Rasti në fjalë nuk përbën gjuhë të urrejtjes për atë se nuk kemi të bëjmë me një shprehje të publike të një qëndrimi diskriminues, pra nuk ka thirrje për të nxitur për të diskriminuar. Rrjedhimisht, ndonëse gjuha e urrejtjes paraqitet si diskriminim, diskriminimi si koncept është më i gjerë që mundet të paraqitet përpos si gjuhë e urrejtjes, edhe si trajtim i pafavorshëm, dallim, preferencë apo përjashtim.

Bibliografia

Burimet Ligjore:

- Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008.
- Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Kodi Nr. 06/L-074 Kodi Penal i Republikës së Kosovës, 2019.
- Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Praktika Gjyqësore:

- Gjykata Themelore Pejë, Rasti P.nr. 319/20;
- Gjykata Themelore Ferizaj, Rasti P.nr.620/16;
- Gjykata Themelore në Gjakovë, P. nr. 655/18;
- Gjykata Themelore në Prishtinë, PS. nr. 20/19;
- Gjykata Themelore në Gjiilan, P. nr. 1133/15;
- *Sunday Times v United Kingdom* App no 6538/74;
- *Vogt v Germany* App no 1785/91;
- *T v Belgium* App no 9777/82;
- *Perinçek v Switzerland* App no 27510/08.

Artikuj dhe raporte:

- <https://betimiperdrejtesi.com/deputeti-qe-u-denua-per-deklaratat-e-tij-fyese-per-masakren-e-recakut-kerkon-pafajesine-ne-apel-prokuroria-kerkon-te-refuzohet-ankesa-e-tij/>
- <https://betimiperdrejtesi.com/avokati-thote-se-ceshtja-penale-ndaj-deputetit-ivan-to-dosijeviq-nuk-mund-te-vazhdoje-tutje-pasi-i-njejt-ka-imunitet-ndaj-ndjekjes-penale/>

Ambasada Holandeze në Kosovë jo domosdoshmërisht i ndanë pikëpamjet dhe interpretimet e shprehura në këtë dokument.



Kingdom of the Netherlands

